

## **SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2023.**

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike Big Gold sh.p.k.

Njesia ekonomike Big Gold sh.p.k e krijuar me date 23.03.2016 ushtron aktivitetin e saj ne fushen Supermarketeve FIER Lagjja 16 Prilli, Rruga Aulona, Godina Nr.60/9330 .

Per periudhen 01 Janar 2023 deri me 31 Dhjetor 2023 jane pergatitur dhe paraqitur paketa e plote e pasqyrave financiare, te cilat japin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiare, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte pergjegjesi e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit(KKK). Gjuha e perdorur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdorur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithë periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitja e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjetër kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo trasaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

### **❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.**

Paraqitja e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e plote te standardeve te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

#### **I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.**

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **40,122,401 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;

##### **⊕ Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA**

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **38,370,873 leke** te cilat jane te perbera nga;

**1.Aktive monetare 7,737,243 leke.** Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen lek ne date 31.12.2023.

**2.Te drejta te arketueshme** te cilat jane paraqitur ne vleren **6,573,272 leke** dhe eshte e perbere nga;

**Zeri, Nga aktiviteti i shfrytezimit** ne vleren vleren **6,573,272 leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilen përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, te paraqitura me vleren neto te realizueshme.



**3. Inventari** i paraqitur ne vleren **24,060,357 leke**, i cili eshte i perbere prej;

*Zeri Mallra* ne vleren **24,060,357 leke te cilat** jane njohur dhe vleresuar ne perputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit eshte vleresuar me metoden e koston mesatare te ponderuar.

Mallrat e blera gjate periudhes ushtrimore jane **160,007,774 leke** dhe kosto e mallrave te shitur e cila eshte pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte **157,370,187 leke**.

**+ Informacione shpjeguese te AKTIVET AFATGJATA**

Aktivitet afatgjata jane paraqitur ne Vleren Kontabel Neto **1,751,528 leke**. Ato jane evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 5 Aktivitet afatgjata materiale dhe aktivitet afatgjata jomateriale. Paraqitja e tyre eshte bere nepermjet politikës kontabel Metoda e Koston. Perberja e ketij zeri paraqitet si vijon;

**1. Aktive afatgjata materiale** jane ne **1,751,528 leke** dhe eshte i perbere nga zeri

*Të tjera Instalime dhe pajisje* ne vleren **1,299,258 leke**.

Ne tabelen e amortizimit perbejne zerat e Makineri dhe Pajisje Energjitike

Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur , dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren **351,757 leke**.

*Pajisje kompjuterike, pajisje zyre* ne vleren **452,270 leke**.

Ne tabelen e amortizimit perbejne zerin PAJISJE KOMPJUTERIKE DHE INFORMATIKE. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur , dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren **150,757 leke**

Ne te jane te perfshire elementet e meposhtem;

Nr. Llogarie	Emertimi i Llogarise	Monedha	Debi	Kredi
2182	<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	LEK	6,337,077	
2188	<i>Pajisje Kompjuterike ,pajisje zyre</i>	LEK	2,191,671	
281802	<i>Per Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	LEK		351,757
281803	<i>Per Pajisje Informative</i>	LEK		150,757



## II. Informacione Shpjeguese per DETYRIMET.

Detyrimet e paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **27,290,869 leke** dhe perbejne detyrimet e periudhave afashkurtra. Detajimi jepet nepermjet informacioneve shpjeguese si vijon;

### + Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra jane paraqitur ne total ne vleren **27,290,869 leke**, dhe jane te perbera nga detyrimet ndaj furnitoreve, punonjesve , detyrime ndaj shtetit per tatime dhe taksa.

- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **15,367,344 leke** paraqesin detyrimin e papaguar per blerjen e mallrave nga furnitore te ndryshem te njesise ekonomike ne fund te vitit 2023.

- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore ne vleren **10,028,229 leke** perbejne detyrimin per sigurimet shoqerore dhe shendetsore,TAP per muajin Dhjetor 2023 ,paga e shperblime dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Sigurime Shoqerore	431	252,001
Tatimin mbi te ardhurat personale	442	2,294,827
Paga Dhe Shperblime	421	7,481,401

Numri mesatar i punonjesve per vitin 2023 eshte 16.

- Të pagueshme për detyrimet tatimore ne vleren**1,895,296 leke** perbejne detyrimin per muajin Dhjetor 2023 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Shteti- TVSh për tu paguar	4453	1,629,814
Tatimi mbi Fitimin	444	265,482

### Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATGJATA

Detyrimet afatgjata jane paraqitur ne total ne vleren **0 leke**.



### III. Informacione Shpjeguese per KAPITALIN

Kapitali i paraqitur ne vleren **12,831,532leke** dhe eshte i perbere nga zerat Kapital i nenshkruar, Fitime te Pashperndara dhe Fitim / Humbje e vitit, detajimi i te cilave do te jepet ne informacionet shpjeguese.

#### 1. Informacione shpjeguese te zerit KAPITAL

Ne kete ze jane paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe jane përmbledhur tepricat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali i paguar,	101	4,000,000
Totali		<u>4,000,000</u> leke

Ne perputhje me aktin e themelimit date 23.03.2016 kapitali i kontribuar eshte i perbere nga Kuota ose aksione, gjithsej:

1-Shoq. BigAlbGroup Shpk me nr)aksione 4.000.000 leke qe perben 100 (%) te kapitalit themeltar

#### 2. Informacione shpjeguese te zerit REZEVRA TE TJERA

Zeri *Reverza Ligjore* paraqitet ne vleren totale neto **400,000 leke** dhe perfshine rezerven ligjore te njesise ekonomike.

Zeri Rezerva te tjera ne vleren totale neto **0 leke** dhe perfshine rezervat e tjera qe disponon njesia ekonomike.

#### 3. Informacione shpjeguese te zerit FITIM / HUMBJE E VITIT

Zeri *Fitim / Humbje e vitit* paraqitet ne vleren **8,431,532 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.

#### ❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar nje fitim ne vleren **8,431,532leke**.

**Zeri Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit** te paraqitura ne pasqyre me vleren e tyre neto **199,546,472leke** evidenton:

Te ardhura nga shitja e Produktit te Mallrave me vleren e tyre neto **193,823,011 leke**.



**Zeri Të ardhura te tjera te shfrytezimit** te paraqitura ne pasqyre me vleren e tyre neto **5,723,461 leke** evidenton:

Te ardhura nga shitja e Shërbimeve me vleren e tyre neto **5,682,611 leke**

**Zeri Te Tjera** ne vleren **40,850 Leke** jane:

Elementi	Ref	Vlera
Fitim nga kembimi valutor	669	40,850

**Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme** te paraqitura ne vleren **157,370,187 leke** perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje. Politika kontabel eshte paraqitur me larte ne zerin *Mallra per shitje* (Inventar).

**Zeri Shpenzime të personelit** i cili eshte i paraqitur ne vleren **21,553,036 leke** perfaqeson:

1. Shuma *Paga dhe shpërblime* gjate periudhes ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023 ne vleren **19,896,095 leke**
2. Shuma *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)* gjate periudhes ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023 ne vleren **1,656,941 leke**.

**Zeri Shpenzime konsumi dhe amortizimi** – i cili eshte i paraqitur me vleren **502,513 leke**, perfaqeson amortizimin e aktiveve afatgjata per periudhen ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023.

**Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi** te cilat jane te paraqitura ne vleren **9,706,756 leke** perfaqesojne shpenzimet te cilat jane kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesise ekonomike, dhe perfaqeson zera te shpenzimeve si furnitura, taksa te ndryshme ,diferenca negative dhe pozitive nga kurset e kembimit dhe te tjera.

**Zeri Shpenzime të tjera financiare** te cilat jane te paraqitura ne vleren **408,420leke**, perfaqesojne te ardhurat dhe shpenzimet qe vijne nga interesa bankare,

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare jane paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësinë ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja eshte bere sipas metodes indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;

**Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit** ne vleren **8,633,024 leke**. Fluksi pozitiv ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga, detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave jane me te ulta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike.



Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren -35,100 leke i cili ka ardhur si rezultat i blerjes se aktiveve afatgjate materiale.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit ne vleren -7,167,427 leke i cili ka ardhur si rezultat i dividendit te paguardhe huase te paguar.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT .**

Ndryshimet ne zerin Kapital kane ardhur si rezultat;

Fitim / Humbje e vitit ne vleren 8,431,532 leke.

Informacionet shpjeguese per zerat e mesiperm jane dhene ne pasqyren e Bilancit.

Drejtuesi

Mirela Sulaj



Hartuesi

Anxhela Shehaj

